

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK KORÇË

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit

Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Korçë

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjiellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht më cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe "Bilancin e Ujit" në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vete për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikave e faturimit më matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

"Bilanci i Ujit" si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjiellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga "lart-poshtë" (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Korçë

Shoqëria rajonale UK Korçë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Korçë, UK Maliq, UK Kolonjë, UK Devoll, UK Pustec. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Korçë jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, probleme të nën faturimit me matje u konstatua për ish shoqëria Kolonjë (69.4 l/ditë për banor) e cila duhet të kryejë verifikimet mbi lidhjet dyfishë në rrjetet e furnizimit sidomos në zonat rurale. Probleme me faturimin aforfe rezultuan në njësit Pustec, Korçë, Kolonjë. Njësia Pustec duhet të analizojë arsyet e mbifaturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktivë), sepse dihet që konsumi mesatar për banor për këtë lloj faturimi referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 duhet të jetë 150 litra/banor në ditë. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëritë UK Korçë dhe

UK Kolonjë, duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e nën faturimit të tyre.

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Korçë	Popullsia me shërbim	Konsumi total (në m ³)	Konsumi i matur (në m ³)	Konsumi i pamatur (në m ³)	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							(l/ditë, banor)		
Korçë	73,293	2,432,000	2,406,000	26,000	28,897	1,113	93.4	26.2	90.9
Maliq	19,795	682,000	607,000	75,000	8,870	1,029	93.8	99.9	94.4
Devoll	22,104	934,000	934,000	-	8,584	0	115.8	0.0	115.8
Kolonjë	9,692	248,000	94,000	154,000	1,562	2,515	69.4	70.6	70.1
Pustec	919	56,000	55,000	1,000	787	8	165.6	296.3	166.9
Totali	125,803	4,352,000	4,096,000	256,000	48,700	4,665	97.7	63.8	94.8

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh .R. UK Korçë	Popullsia e Shërbyer*	Uji i Prodhuar që futet në sistem (në m ³)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimit (m ³ /vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Korçë	73,293	4,729,930	90.9	74,875	12,614,000	461.6	+370.7
Maliq	19,795	1,182,460	94.4	29,451	1,424,000	132.5	+38.1
Devoll	22,104	1,568,208	115.8	23,390	3,090,528	362	+246.2
Kolonjë	9,692	410,400	70.1	9,692	2,003,000	566.2	+496.1
Pustec	919	96,000	166.9	1,647	4,104,000	6827	+6660
Totali	125,803	7,986,998	94.8	139,025	23,235,528	457.8	+363.0

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë për llogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2, shihet se shoqëria rajonale UK Korçë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për ish Shoqërinë UK Korçë

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Korçë ka prodhuar 4,729,930 m³ ujë, **i cili rezulton 100% i matur** nga Bilanci i ujit ndërsa nga raportimi tek të dhënat e sektorit të monitorimit rezulton 81% e matur dhe 19% e vlerësuar, ku përfshihen zonat rurale. Shërbimi me ujë ofrohet për rreth 98% të popullsisë në juridiksion, numri i lidhjeve për këtë shërbim raportohet 33,486 lidhje prej të cilave 32,320 lidhje janë të pajisur me ujëmatës.

“UPA” rezulton në nivelin 39.79%, i cili është një nivel i mirë krahasuar me shoqëritë e tjera. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA).

Në tabelën 3, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Korçë.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për ish Shoqërinë UK Korçë- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	4,729,930	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,847,993	60.21%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	-	0.00%
Faturimi Total	2,847,993	60.21%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	530	0.01%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	192,348	4.07%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	200,000	4.23%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	236,497	5.00%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	628,845	13.30%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	241,729	5.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	107,833	2.28%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	100,000	2.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	800,000	16.91%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	3,000	0.06%
Humbjet Reale (Teknike)	1,252,562	26.48%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,881,407	39.78%
UJI PA TË ARDHURA	1,881,937	39.79%

Komente:

- UPA në nivelin 39.79% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivel të mirë në krahasim me sektorin në përgjithësi.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin 100%.
- Niveli i humbjeve reale është 26.48% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin (16.91%) dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit (5.11%).
- Numri i klientëve me ujëmatës është 32,320 klientë dhe përbëjnë 96.5% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 8.3% të prodhimit vjetor.

Rekomandime:

- *Të merren masa që volumi i ujit që hyn në sistem të jetë 100% i matur sepse 19% që i përket zonës rurale është akoma i vlerësuar (sipas raportimit në sektorin e monitorimit).*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes fizike jo të mirë të rrjetit, sidomos për zonën rurale, dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në uljen e UPA-s.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin e nën faturuar, për të gjetur shkaqet reale të këtij fenomeni.*

II.2 UPA për ish Shoqërinë UK Maliq

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Maliq ofrohet për 67.2% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 1,182,460 m³ ujë, **prej të cilit 57% është i matur** pjesa tjetër i vlerësuar. Numri i lidhjeve me ujin raportohet 10,306 lidhje ku 89.6% e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 60.64% të prodhimit ndërsa “Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 39.36%.

Në Tabelën 4, jepen komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë Maliq. Theksojmë që kjo ish shoqëri nuk e ka dërguar Bilancin për vitin 2022 edhe pas insistimit nga ERRU, kështu që bilanci më poshtë u plotësua nga vet sektori Teknik me të dhënat që shoqëritë raportojnë tek sektori i monitorimit dhe duke marrë në konsideratë bilancin e vitit 2021.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për ish Shoqërinë UK Maliq – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	1,182,460	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	637,000	53.87%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	80,000	6.77%
Faturimi total	m³	717,000	60.64%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	m³	9,000	0.76%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	m ³	53,960	4.56%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	100,000	8.46%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	54,000	4.57%
Humbjet e dukshme (administrative)	m³	207,960	17.59%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	60,000	5.07%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	1,500	0.13%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	m ³	5,000	0.42%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	m ³	180,000	15.22%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	m ³	2,000	0.17%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	m³	248,500	21.02%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	m³	456,460	38.60%
UJI PA TË ARDHURA	m³	465,460	39.36%

Komente:

- UPA në nivelin 39.36% të volumit të prodhuar vjetor, konsiderohet në nivel të mirë.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin 57%.
- Niveli i humbjeve reale është 21% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 15.22% dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 5.07%.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 9,238 klientë dhe përbëjnë 89.6% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 17.59% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 13.02% të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj në nivelin 4.57%.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se sasia e ujit të vlerësuar është në nivelin 43%.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që vetëm 57% e ujit të prodhuar matet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim për pjesën e sasisë së ujit të vlerësuar është e domosdoshme. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo nga burimet e brendshme të shoqërisë rajonale për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 15.2%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e ujit pa të ardhura.
- Në lidhje me humbjet e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarës prej 8.46%, Shoqëria (Njësia) duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, krahas verifikimeve në terren (task-force) për lidhje dytësore sidomos në pronat private në zonat rurale, që mund të përdorin lidhje dytësore për ujitje.

II.3 UPA për ish Shoqërinë UK Devoll

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Devoll ofrohet për 94.5% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet i vlerësuar dhe në sasinë 1,568,208 m³ ujë, **prej të cilit 45% është i matur** pjesa tjetër 55% i vlerësuar.

Nga raportimi i të dhënave, faturimi rezulton 60.54% e prodhimit, ndërsa “Uji Pa të Ardhura” në nivelin 39.46%. Ish shoqëria UK Devoll ka në administrim 9,163 lidhje me ujin, të cilat faturohen të gjitha me matës. Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës bëhet në bazë të DMA-ve.

Në Tabelën 5, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Devoll mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit .

Tabela 5. Bilanci i Ujit për ish Shoqërinë UK Devoll – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	1,568,208	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	949,340	60.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	-	0.00%
Faturimi Total	949,340	60.54%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	5,900	0.38%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	50,000	3.19%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	75,000	4.78%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	71,110	4.53%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	196,110	12.51%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	90,000	5.74%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	40,000	2.55%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	25,000	1.59%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	259,000	16.52%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetësimit	2,858	0.18%
Humbjet Reale (Teknike)	416,858	26.58%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	612,968	39.09%
UJI PA TË ARDHURA	618,868	39.46%

Komente:

- UPA në nivelin 39.46% të volumit të prodhuar vjetor, konsiderohet në nivel të mirë.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin 45%.
- Niveli i humbjeve reale është 26.58% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve, ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 16.52% dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 5.74%.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 9,163 klientë që përbën 100% të numrit total të tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 12.51% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 7.97 % të prodhimit vjetor dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim në nivelin 4.53%.
- Duke qenë se sasia e ujit të vlerësuar është në nivelin 55% është mjaft e mundshme ekzistenca e pasaktësise gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar, dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.
- Konsumi total i faturuar në nivelin 60.54%, i cili është i matur, pasi të gjithë klientët janë të pajisur me matës individuale.

Rekomandime:

- *Duke qenë se vetëm 45% e ujit të prodhuar matet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim për pjesën e sasisë së ujit të vlerësuar është e domosdoshme. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo nga burimet e brendshme të shoqërisë rajonale për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 16.52 %, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, pasi kjo shoqëri ka një sistem të ri të furnizimit me ujë për qytetin e Bilishtit, por kjo humbje është mjaft e mundshme që të vijë nga zonat rurale të saj, kështu që të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e UPA-s.*
- *Në lidhje me përçindjen që zënë humbjet e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe në atë shpërndarës 7.97% njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, krahas verifikimeve në terren (task-force) për lidhje dytësore sidomos në pronat private në zonat rurale që mund të përdorin lidhje dytësore për ujitje.*

II.4 UPA për ish Shoqërinë UK Kolonjë

Në Njësinë Administrative Kolonjë shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 100% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë 410,400 m³ ujë dhe është i vlerësuar.

Treguesi i UPA rezulton në nivelin 27.26%, duke u renditur si njësia më e mirë e kësaj shoqërie rajonale por duhet patur parasysh që kjo shoqëri raporton volumin e ujit të prodhuar 100% të vlerësuar dhe e ka sistemin me rrjedhje të lirë. Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 72.74%.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 4,363 lidhje, nga të cilat 42% faturohet me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe.

Lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe në atë të transmetimit janë fare të vogla me pak se 1%.

Në Tabelën 6, paraqitet Bilanci i Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Kolonjë.

Tabela 6. Bilanci i Ujit për ish Shoqërinë UK Kolonjë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	410,400	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	143,530	34.97%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	155,000	37.77%
Faturimi Total	298,530	72.74%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	900	0.22%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,500	0.37%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	1,720	0.42%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	4,750	1.16%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	7,970	1.94%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	16,000	3.90%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	8,000	1.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	8,000	1.95%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	69,000	16.81%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	2,000	0.49%
Humbjet Reale (Teknike)	103,000	25.10%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	110,970	27.04%
UJI PA TË ARDHURA	111,870	27.26%

Komente :

- UPA në nivelin 27.26 % të volumit të prodhuar vjetor, konsiderohet në nivelin më të mirë në sektorin e ujit në vend.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 72.74%, prej të cilit 34.97% përbën konsumin e faturuar të matur.
- Niveli i humbjeve reale është 25.10% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve në rrjetin shpërndarës në nivelin 16.81% dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 3.9%.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 1,840 klientë dhe përbëjnë 42% të totalit të klientëve.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 1.94% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, një vlerë e tillë mjaft e vogël që e bën atë të pabesueshme.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se sasia e ujit është 100% e vlerësuar dhe e ka sistemin me rrjedhje të lirë, vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

Rekomandime:

- Duke patur parasysh që shoqëria i ka burimet e ujit të shfrytëzueshme krejtësisht pa matës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo nga burimet e brendshme të shoqërisë rajonale për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.

- Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 16.81%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktim e UPA.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar minimizimin e humbjeve të dukshme.

II.5 UPA për ish Shoqërinë UK Pustec

Shërbimi i furnizimit me ujë ne Njësinë Administrative Pustec ofrohet për 56% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor i vlerësuar raportohet 96,000 m³ ujë, prej të cilit **66% është i matur** pjesa tjetër i vlerësuar.

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 817 lidhje prej të cilave 99% janë të pajisur me ujëmatës. Konsumi total i faturuar rezulton në nivelin 60.42% e prodhimit, prej të cilit vetëm 1 % është konsum i faturuar i pamatur.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin 39.58%.

Në Tabelën 7, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Pustec mbi bazën e të cilave është kryer Bilanci dhe analiza e humbjeve të ujit .

Tabela 7. Bilanci i Ujit për ish Shoqërinë UK Pustec – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	96,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	57,000	59.38%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	1,000	1.04%
Faturimi total	m³	58,000	60.42%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	m³	500	0.52%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	m ³	-	0.00%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	-	0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	10,600	11.04%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	m³	10,600	11.04%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	4,500	4.69%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	2,000	2.08%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	m ³	1,200	1.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	m ³	18,500	19.27%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve ne linjat e sistemit të Ujësjetllësit	m ³	700	0.73%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	m³	26,900	28.02%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	m³	37,500	39.06%
UJI PA TË ARDHURA	m³	38,000	39.58%

Komente :

- UPA në nivelin 39.58 % të volumit të prodhuar vjetor, konsiderohet në nivelin të mirë.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 60.42%, prej të cilit 1.04% është konsum i faturuar i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 28.02% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 19.27% dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit 4.69%. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 11.04% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, e cila vjen nga zëri i humbjeve nga pasaktësia në matje, nën faturimi, ndërkohë që raportohet mungesë e lidhjeve të paligjshme.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 809 klientë dhe përbejnë 99% të totali të klientëve që e marrin këtë shërbim.
- Duke qenë se vetëm 66% ujit të prodhuar matet ka pasaktësi në përlllogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar, rrjedhimisht edhe në llogaritjen e treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke qenë se vetëm 66% e ujit të prodhuar matet është i nevojshëm instalimi i matësve në të gjithë burimet e tij. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo nga burimet e brendshme të shoqërisë rajonale për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 19.27 %, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e UPA.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 11.04% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësit apo tek nën faturimi duke kolauduar matësit/ndërruar matësit e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve etj.*

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Korçë

Shoqëria Rajonale UK Korçë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Korçë, Maliq, Devoll, Kolonjë, Pustec ka në juridiksion 139,025 banorë. mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për 125,803 banorë ose **90.5%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 58,135 lidhje, nga të cilat 53,370 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatësi.

Prodhimi vjetor **7,986,998 m³ rezulton i matur në nivelin 66%**, nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është imediate për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin **39.01%** të ujit që hyn në sistem dhe shoqëria faturon **4,870,863 m³** ujë ose **60.98%** të prodhimit.

Tabela 8, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Korçë.

Tabela 8. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Korçë – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (ne m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,986,998	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,634,863	58.03%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	236,000	2.95%
Faturimi Total	4,870,863	60.98%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	16,830	0.21%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	297,808	3.73%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	376,720	4.72%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	376,457	4.71%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	1,050,985	13.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	412,229	5.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	159,333	1.99%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	139,200	1.74%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,326,500	16.61%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	10,558	0.13%
Humbjet Reale (Teknike)	2,047,820	25.64%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	3,098,805	38.80%
UJI PA TË ARDHURA	3,115,635	39.01%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 39.01% të prodhimit vjetor, është në nivelin e mirë të performancës.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar” në vlerën prej 66% gjithsesi cenon vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivelin e besueshmërisë së treguesit UPA.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 60.98%, prej të cilit vetëm 2.95% është konsum i faturuar i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 25.64% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku 16,61% vijnë nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe 5,16% nga linjat e transmetimit. Shoqëria duhet të japë argumente të mëtëjshme për justifikimin e tyre dhe të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 13.16% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku në 8,45% vlerësohen se vijnë nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje dhe 4,71% nga pasaktësia në matje, nën faturim etj.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 53,370 klientë që përbën 92% të totalit të klientëve.
- Duke qenë se vetëm 66% ujit të prodhuar matet është e mundshme ekzistenca e pasaktësisë në vlerësimin e sasisë së ujit të prodhuar dhe njëkohësisht të vlerësimit të treguesit UPA.

- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi nga stafet përkatëse hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit

Rekomandime:

- *Duke qenë se vetëm 66% ujit të prodhuar matet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 16.61%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, që mund të jenë kryesisht në zonat rurale pasi zonat urbane kanë sistem kryesisht të ri, të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e UPA.*
- *Të bëhen përpjekje për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale që mundëson një evidentim, monitorim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Të ngrihet grup pune, i cili vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë për verifikime në vend për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar, e mundësisë së lidhjeve dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si dhe kontroll të punës së lexuesve të matësve.*
- *Për korrigjimin e normave të faturimit me matje, shoqëria duhet të angazhohet në gjetjen e lidhjeve dyfishe. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërinë rajonale, duke filluar me vitin 2023, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese. Për këtë duhet të caktohet një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*